

V E N D I M
Nr.182, datë 25.4.1995

PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE

Në bazë të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave nga grosistët caktohet deri në 15 për qind mbi çmimin fillestar të blerjes CIF, konvertuar në lekë sipas kursit përkatës ditor që njoftohet nga Banka e Shqipërisë.

Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave nga prodhuesit e vendit caktohet deri në 20 për qind mbi koston e prodhimit.

2. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me pakicë të barnave nga farmacitë e rrjetit të hapur, sipas propozimit të komisionit të çmimeve të barnave, caktohet deri në 35 për qind mbi çmimin e blerjes që del pas shtesës që i bëhet atij sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Struktura e çmimeve të barnave të listës kryesore, për efekt të rimbursimit, miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, sipas propozimit të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

4. Çmimet e shitjes reference të barnave të listës kryesore shërbejnë si kufij maksimalë në llogaritjen e masës së rimbursimit të çmimeve të barnave të kësaj liste dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha farmacitë e rrjetit të hapur.

Farmacitë i afishojnë në vende të dukshme çmimet e shitjes së barnave për popullsinë sipas emërtesës së listës kryesore, si dhe listën e barnave thelbësore.

5. Miratohet lista e barnave thelbësore sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor rimbursor 100 për qind recetat për barnat thelbësore për fëmijët 0-12 muaj, për invalidët e Luftës, për invalidët e grupit të I-II për sëmundjet për të cilat kanë dalë invalidë, për kurimin e TBC-së dhe të kancerit sipas listës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe rimbursor 50 për qind recetat për invalidët e grupit III-IV për sëmundjet për të cilat kanë dalë invalidë.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit cakton listën e barnave thelbësore të nevojshme për kurimin e sëmundjeve të TBC-së dhe të kancerit.

7. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ka kompetencë që gjatë vitit të bëjë ndryshime në strukturën e çmimeve të barnave të listës kryesore sipas pikës 3 të këtij vendimi.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.17, datë 24.1.1994 “Për ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të barnave dhe vendosjen e kufijve maksimalë të shitjes së tyre nga subjektet private”, nr.483, datë 29.8.1994 “Për vendosjen e kufijve maksimalë të çmimit të shitjes së barnave nga subjektet private”, nr.525, datë 17.10.1994 “Për subvencionimin nga shteti të barnave thelbësore”, nr.51, datë 23.1.1959, pika 3 “Për masat për uljen e mëtejshme të vdekjeve në fëmijët e moshës së gjirit”, nr.83, datë 16.3.1983, pika 2 “Për uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të disa barnave të vendit dhe të importit”, nr.247, datë 27.5.1993 “Për subvencionimin nga shteti të një pjese të faturës së shpenzimeve për preparatet mjekësore të nevojshme për mjekimin e invalidëve”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi